

UDHËZIM
Nr. 25, datë 1.12.2020

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019,
“PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET
E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
 - a) kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi “në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi”, zëvendësohet me togfjalëshin “sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik”.
 - b) në pikën 18 të kreut IV/4, togfjalëshi “... brenda datës 30 nëntor ...”, zëvendësohet me togfjalëshin “... brenda datës 15 dhjetor ...”.
 - c) pika 1 dhe 1.1 të kreut V, ndryshojnë, si më poshtë:
 - “1. IAL-të dorëzojnë në QSHA, në formë shkresore dhe elektronike:
 - a) brenda datës 30 nëntor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.
 - b) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.
 - c) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe të studentëve që i përkasin pakicës kombëtare romë dhe egjiptiane në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.
 - d) brenda datës 15 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve shtetas të huaj në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.
 - e) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë të studimeve, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve”, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.
 - f) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e ciklit të dytë të studimeve, për

pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

g) brenda datës 21 dhjetor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar në programet e ciklit të tretë të studimeve, “Master ekzekutiv”, për pajisjen me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

d) Pas pikës 4, të kreut V, shtohet pika 4/1, me përmbajtje si më poshtë:

“4/1. Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, përjashtimisht për vitin akademik 2020–2021, ngarkohen të ndryshojnë kalendarin, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, në programet e ciklit të dytë të studimeve, “Master profesional”/“Master i shkencave”/“Master i arteve”, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit me transferim studimesh dhe program të dytë studimi në programet e ciklit të dytë të studimeve, si dhe për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv”, deri në datë 15.12.2020.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi